



DEKLARATA

Date 12 /03/ 2023

URDHRI I INXHINIERIVE

ENGINEERING ORDER
INXHINIERET E DISIPLINAVE
ENGINEERING DISCIPLINES

Profesionistët që janë të pajisur me Titullin ‘‘Inxhinier’’, që kanë përfunduar Edukimi e Lartë Universitar në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar me vendet e tjera, me qëllim krijimin e një bashkimi të interesave profesionale, gjithnjë e më të ngushtë midis disiplinave profesionale të tyre, janë të vendosur të ndajnë një të ardhme paqësore, të bazuar në vlerat e përbashkëta, si edhe qëllimisht e veçanërisht për të hartuar mekanizmin e bashkëpunimit institucional midis secilit Urdhër Profesional Përkatës, e ne vijim zbatimit të së drejtës së ushtrimit të profesionit, të gjithë secilit në disiplinat përkatëse.

Të ndërgjegjshëm për trashëgiminë profesionale dhe të drejtave dhe detyrimeve të çdo disipline përkatëse të inxhinierive, së bashku themeluan **URDHRIN E INXHINIERIVE** mbi vlerat e pandashme universale të dinjitetit njerëzor të çdo profesionisti, lirisë së ushtrimit të profesionit, të barazisë dhe solidaritetit në shërbim të tyre. Të drejtat dhe detyrat e çdo profesionisti janë të bazuara në parimet e sundimit të ligjit dhe rregullave, si edhe vendos individin në qendër të aktiviteteve, duke krijuar mbrojtjen e interesit publik, të sigurisë kombëtare, të shëndetit, si edhe duke krijuar një sipërfaqe prej lirisë në shërbim dhe të autonomisë profesionale duke respektuar edhe parimin e shqyrtimit të pavarur.

Bashkimi i inxhinierëve në U -in INXHINIERIVE, kontribuon në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre vlerave të përbashkëta, duke respektuar diversitetin si edhe të Inteligjencës së çdo individi, të çdo Disipline të Inxhinierive dhe të drejtën dhe detyrat e secilit profesion, si dhe identitetet kombëtare dhe organizimin e autoriteteve të tyre publike në nivel kombëtar, rajonal dhe nivelet lokale. Së bashku synojmë dhe kërkojmë të promovojmë një zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm në dhënien e shërbimeve dhe sigurojmë një lëvizje të lirë të Profesionisteve, si edhe veçanërisht të shërbimeve dhe kapitaleve të çdo Profesionisti.

Për këtë qëllim, është e nevojshme për të forcuar mbrojtjen e të drejtave themelore të çdo Disipline Profesionale më vete, nën dritën e ndryshimeve në shoqëri, progresit shoqëror dhe zhvillimet shkencore dhe teknologjik, duke bërë ato të drejta më të dukshme në një Statut dhe të përfaqësuar nga kjo organizatë.

Ky Statut riafirmon, me kujdesin e duhur kompetencat dhe detyrat e Urdhrave Profesional Përkatës dhe parimin e subsidiaritetit, të drejtat si ato rezultojnë, në veçanti, nga traditat Universale e çdo Disipline Profesionale.